



KOMUNA E RAHOVECIT

OPSTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY OF RAHOVEC

KONTRATË

Numri i kontratës:¹ 623-24-600-1-3-6/C562

Emri i Autoritetit Kontraktues: **KUVENDI KOMUNAL - RAHOVECË**, në njërën anë; dhe

Emri i Kontraktuesit: **Naim Shuki B.I., Wesley Clark Pn, PRIZREN**, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për furnizimet e shënuara me poshtë:

Titulli i Kontratës: **FURNIZIM I INSPEKTORËVE ME UNIFORMA DHE FURNIZIM ME UNIFORMA PËR TATIMIN NË PRONË**

Me numër identifikues: 623-24-600-1-3-6

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë: **Furnizim i inspektorëve me uniforma dhe Furnizim me uniforma për tatimin në pronë**, sipas specifikimeve teknike të detyrueshme dhe pjesës së ofertës financiare që janë pjesë e kësaj kontrate.

1.2 Kontrata hynë në fuqi me: **datën e nënshkrimit** dhe përfundon për një periudhë prej **3 Muaj**

1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se [...] nga data e marrjes së urdhërës.

1.4 Vendi i dërgimit të furnizimeve do të jetë: **NË KOMUNËN E RAHOVECIT**

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë **DDP²** (Detyra e Dërguar e Paguar).

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

¹ Ju lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e faturimit dhe pagesës, procedurat dhe transaksionet që lidhen me thesarin.

² DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi total i furnizimeve duhet të jetë: **9,360.00 Euro**;

[Nëntë mijë e treqind e gjashtëdhjetë Euro]

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Furnizuesit sipas kontratës.

3.3 Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

[Autoriteti Kontraktues do të paguaj secilën shumë të detyrimeve pas pranimit të secilës dërgesë]

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i furnizimeve duhet në të gjitha aspektet të plotësojë specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni do të mbetet valid për...muaj, pas pranimit të furnizimeve.

Shume e sigurisë së ekzekutimit është: **10 % e vlerës së kontratës**, për kohëzgjatjen e periudhës prej: **4 muaj** nga data e nënshkrimit të kontratës.

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së furnizimeve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në [Gjykata Themelore Prishtinë] në pajtim me ligjin e Kosovës.

Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhen [Shqip]³ në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Autoritetin Kontraktues:		Për Furnizuesin:	
Emri:	Astrit Mullabazi	Emri:	Naim Shuki
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit	Pozita:	Drejtor
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	21.03.2024	Data:	21.03.2024
Vula:		Vula:	

³ Gjuha do të jetë gjuha e përdorur nga tenderuesi në tenderin e tij.



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republika of Kosovo
Komuna Rahovec / Opština Orahovac / Municipal- Rahovec



DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA
ODELJENJE ZA FINANSIJE I BUDZET
DEPARTMENT OF FINANCE AND BUDGET

SPECIFIKACION - FURNIZIM ME UNIFORMA PËR DREJTORINË PËR BUXHET DHE FINANCA - SEKTORI I TATIMIT NË PRONË

Nr.	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Çmimi për njësi	Totali
1	Furnizim i kompletit dhe pantolla për sezonin Veror:	Copë	6	160.00	960.00
	Kompleti veror (seter pantolla) materiali me permbajtje 70% wool dhe 30% polyester apo polyvisconn (dark blue).				
2	Furnizim i kompletit dhe pantolla për sezonin Dimëror:	Copë	6	162.00	972.00
	Kompleti dimëror (seter pantolla) materiali me permbajtje dimerore 70% wool 30% polyester mirpo trashesia e materialit gjegjesisht stofit te jete me e dalluar nga ajo verore, ngjyra e preferuar teget (dark blue).				
3	Furnizim me Kemisha për sezonin e Verorë:	Copë	12	23.00	276.00
	Kemisha verore me mende te shkurta e cilesise jo me pak se 65% pambuk dhe jo me shume se 35% polyester, ngjyre qielli e preferuara.				
4	Furnizim me Kemisha për sezonin Dimëror:	Copë	12	23.00	276.00
	Kemisha dimerore me mende te gjata e cilesise jo me pak se 65% pambuk dhe jo me shume se 35% polyester, ngjyre qielli e preferuara.				
5	Furnizim me Jakne:	Copë	6	70.00	420.00
	Jaknet duhet te jene dimerore dhe konfor pra te jene model klasik qe do te vishen mbi kostume gjegjesisht permby seter, permbajtja e materialit te jete minimum 30% wool mirpo munde te jete edhe materiali i stofit me te trashe me astar, ngjyra e preferuar e zeze apo teget e erret.				
6	Furnizim me Këpuca Verore:	Palë	6	40.00	240.00
	Kepucat verore te jene lekure origjinale, te kene gjonin neolit, model i shkurte me lidhese ngjyre te zeze				
7	Furnizim me Këpuca Dimërore:	Palë	6	55.00	330.00
	Kepucat dimerore poashtu lekure origjinale, me gjon te gomes me te trashe, me lidhese dhe jo te rreshqitshme				
8	Furnizim me Kravata:	Copë	12	5.00	60.00
	Kravata te pershtatet kompletave te jete nje ngjyre teget (blue) me shtype te kerkuar mbi te.				
9	Jelek me mbishkrimin INSPEKSIONI TATIMOR(me shkronja vezulluese)	Copë	6	35.00	210.00
Gjithsej:					3,744.00



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republika of Kosovo
Komuna Rahovec / Opština Orahovac / Municipal- Rahovec



DREJTORIA PËR PUNË INSPEKTUESE
ODELJENJE ZA INSPEKCIJE
DEPARTMENT OF INSPECTION

SPECIFIKACION - FURNIZIM ME UNIFORMA PËR DREJTORINË PËR PUNË INSPEKTUESE

Nr.	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Çmimi për njësi	Totali
1	Furnizim i kompletit dhe pantolla për sezonin Veror:	Copë	9	160.00	1,440.00
	Kompleti veror (seter pantolla) materiali me përbajtje 70% wool dhe 30% polyester apo polyvisconn (dark blue).				
2	Furnizim i kompletit dhe pantolla për sezonin Dimëror:	Copë	9	162.00	1,458.00
	Kompleti dimëror (seter pantolla) materiali me përbajtje dimerore 70% wool 30% polyester mirpo trashesia e materialit gjegjesisht stofit të jete me e dalluar nga ajo verore, ngjyra e preferuar teget (dark blue).				
3	Furnizim me Kemisha për sezonin e Verorë:	Copë	18	23.00	414.00
	Kemisha verore me minge te shkurta e cilesise jo me pak se 65% pambuk dhe jo me shume se 35% polyester, ngjyre qielli e preferuara.				
4	Furnizim me Kemisha për sezonin Dimëror:	Copë	18	23.00	414.00
	Kemisha dimerore me minge te gjata e cilesise jo me pak se 65% pambuk dhe jo me shume se 35% polyester, ngjyre qielli e preferuara.				
5	Furnizim me Jakne:	Copë	9	70.00	630.00
	Jaknet duhet te jene dimerore dhe konfor pra te jene model klasik qe do te vishen mbi kostume gjegjesisht permby seter, përbajtja e materialit te jete minimum 30% wool mirpo munde te jete edhe materiali i stofit me te trashë me astar, ngjyra e preferuar e zeze apo teget e erret.				
6	Furnizim me Këpuca Verore:	Palë	9	40.00	360.00
	Kepucat verore te jene lekure origjinale, te kene gjonin neolit, model i shkurte me lidhese ngjyre te zeze				
7	Furnizim me Këpuca Dimërore:	Palë	9	55.00	495.00
	Kepucat dimerore poashtu lekure origjinale, me gjon te gomes me te trashë, me lidhese dhe jo te rreshqitshme				
8	Furnizim me Kravata:	Copë	18	5.00	90.00
	Kravata te pershtetet kompletave te jete nje ngjyre teget (blue) me shtype te kerkuar mbi te.				
9	Jelek me mbishkrimin INSPEKSIONI(me shkronja vezulluese)	Copë	9	35.00	315.00
Gjithsej:					5,616.00



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republika of Kosovo
Komuna Rahovec / Opština Orahovac / Municipal- Rahovec



DREJTORIA PËR PUNË INSPEKTUESE
ODELJENJE ZA INSPEKCIJE
DEPARTMENT OF INSPECTION

RIKAPITULLIMI		
1	FURNIZIM ME UNIFORMA PËR DREJTORINË PËR BUXHET DHE FINANCA - SEKTORI I TATIMIT NË PRONË	3,744.00
2	FURNIZIM ME UNIFORMA PËR DREJTORINË PËR PUNË INSPEKTUESE	5,616.00
Totali:		9,360.00

Vërejtje:

1. Përfituesi i kontratës në bashkëpunim me AK do të marrë numrat e madhësisë dhe masën për çdo artikull sipas specifikacionit dhe për secilin punëtor të Inspekcionit.
2. Çmimi duhet të jetë konformë të gjitha tatimeve dhe detyrimeve në Republikën e Kosovës